



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	181/24
Nr. i fq. / Br. st	- 8 -
Data: / Datum	21.10.2024
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUÇITRN

### PROCESVERBAL

nga mbledhja e VIII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13 shtator 2024 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Hava Rruka Mlinaku (Nënkryetare e komunës), drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – deklaroi se të gjitha materialet për këtë mbledhje na kanë ardhur jashtë afateve ligjore, që parashihen me LVL, statut e rregullore. Kësisoj, konsideroj se kjo mbledhje e KPF-së është e kundërligjshme, për shkak se nuk janë respektuar afatet ligjore për dërgimin e materialit prej shtatë ditësh. Prandaj, kjo nuk është edhe hera e parë. Të ndodhë kjo vonesë, pas muajit gusht që ka qenë pushim është e pafalshme dhe e papranueshme. Kërkoj nga ti si kryesuese që ta anuloni këtë mbledhje dhe ta caktoni një mbledhje tjetër brenda afatit ligjor.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – edhe unë kam vërejtje sa i përket kësaj çështjeje, sepse është bërë e tepërt. Sot na erdhi draft-buxheti, që është pika më e rëndësishme dhe na duhet kohë për ta analizuar. Kurse, në ora 14:00 është dëgjimi publik për draft-buxhetin. Të kam thënë edhe më herët kryesuese, se pse po e lejon veten me ra në këtë nivel. Mos e lejo veten të bjen në këtë nivel për shkak të disa drejtorëve të drejtorive.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – lidhur me këtë po ju jap sqarime që janë të njëjta. Unë në bashkëpunim me sekretarinë, përveç që e kanë planin e punës, i njoftojmë përsëri drejtorët e drejtorive se cila është data e fundit për sjelljen e materialeve. Kësaj radhe, nuk e kemi dorëzuar materialin të premtën, për shkak të dy pikave: draft-buxhetit dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditorit, sepse na premtuan nga drejtoritë që do të përgatiten të hënën. Por, pasi që nuk i sjellën të hënën, e dërguam ftesën me ato materiale që i kishim të përgatitura.

Sa i përket dëgjimit të sotëm buxhetor, ky takim më tepër është përmbyllës dhe njoftues se cilat projekte kanë hyrë e cilat jo. Buxheti është draft derisa të kalojë në kuvend dhe deri atëherë mund të ndryshojë, sepse mund të ketë propozime.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – tha se drejtorët që nuk janë në nivel të detyrës dhe nuk kemi nevojë që t'i mbulojmë ne. Ai tha se tri vite ka qenë drejtor dhe së paku një javë

më herët e kam dorëzuar materialin në sekretari dhe asnjëherë nuk kam pritur të më shkruaj kryesuesi për ta dorëzuar materialin.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – Sa i përket shtyrjes së mbledhjes, ajo tha se dalim jashtë afatit ligjor për kuvend. Por, nëse e shihni të nevojshme të mbajmë një mbledhje të jashtëzakonshme të KPF-së për draft-buxhetin mund ta mbajmë. Andaj, po kërkoj mirëkuptimin tuaj që ta vazhdojmë mbledhjen, sepse njëjtë është situata edhe në komunat tjera.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – ti po kërkon prej neve që ta vazhdojmë mbledhjen, kurse draft-buxheti deri në seancën e kuvendit do të ndryshohet përsëri.

Ai tha se gjatë dëgjimeve buxhetore jemi ballafaquar me pyetje nga qytetarët lidhur me projektet e komunës, kurse ne nuk kemi pasur njohuri që t'ju japim përgjigje, sepse zyrtarët e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa kanë munguar në disa takime.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se buxheti është draft deri në seancën e kuvendit, sepse edhe në mbledhje mund të ketë propozime.

Sipas ligjit, dëgjimet buxhetore organizohen nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa bashkë me KPF-në. Sipas kalendarit, në çdo takim e kemi një anëtar të qeverisë komunale apo zyrtar që ka lidhje me buxhetin. Po kërkoj nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në dëgjimet buxhetore të jenë të pranishëm, sepse ata kanë njohuri për projektet dhe buxhetin.

**Komiteti për Politikë dhe Financa me pesë (5) vota “për”, katër (4) “kundër” (Sylejman Mehulli, Fatmire Cecelia, Agron Perçuku dhe Fakete Dushi) aprovoi këtë:**

#### R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.07.2024
2. Shqyrtimi i Propozim – buxhetit për vitet 2025 – 2027 dhe planeve investuese
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar – qershor 2024
4. Shqyrtimi i Raportit i sistemit të menaxhimit të performancës dhe grantit të performancës për vitin 2023
5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023/2024
6. Shqyrtimi i nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndërkomunal për bashkëfinancim me Komunën e Mitrovicës për rregullimin e memorialit të dëshmorit Xhevat Jusufi
7. Rishikimi i Planit të veprimit për të gjeturat e auditorit
8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje – shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore
9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024
10. Pyetje dhe përgjigje

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.07.2024.

**Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për”, aprovoi procesverbalin e datës 15.07.2024.**

## 2. Shqyrtimi i Propozim – buxhetit për vitet 2025 – 2027 dhe planeve investuese.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – deklaroi se bazuar në Qarkoren Buxhetore 01/2025 dhe 02/2025, me marrjen e kufijve buxhetor, ne kemi qenë të obliguar që të mbajë dëgjime publike. Pas marrjes së inputeve nga dëgjimet publike, kemi hartuar projekt-buxhetin, i cili për vitin 2025 do të jetë 27,662,762.00€. Në kategorinë <paga dhe mëditje> kemi 13,811,153.00€, në kategorinë <mallra dhe shërbime> kemi 6,324,837.00€, në kategorinë <shpenzime komunale> kemi 639,625.00€, në kategorinë <subvencione> kemi 1,855,000.00€ dhe në kategorinë <shpenzime kapitale > kemi 5,032,147.00€.

Si risi në vitin 2025, krahasuar me vitin 2024 kemi një ulje të investimeve kapitale prej 1,894,591.00€. Kemi bërë rritjen e mallrave dhe shërbimeve për 1,484,000.00€ si dhe rritje kemi edhe te subvencionet prej 632,000.00€. Arsyeja është se një pjesë e madhe e projekteve, siç është ndërtimi i rrugëve të rendit të katërt, riasfaltimet dhe shërbimet tjera e kanë domenin e mallrave dhe shërbimeve – shërbime kontraktuese.

Jashari tha se shpërndarja e buxhetit nuk është procedurë e lehtë, sepse është e pamundur që të futet të gjitha propozimet që dalin nga dëgjimet publike. Por, është një gjë e mirë se me buxhetin e vitit 2025 janë përfshirë të gjitha fshatrat dhe qyteti. Ai tha se përparësi u është dhënë obligimeve kontraktuale - projekteve dyvjeçare, e pastaj kontratave të nënshkruara dhe projekte të reja të planifikuara. Është e vërtetë që jemi vonuar, sepse është dashur që t'i marrim dhe t'i analizojmë inputet. Por, do të ketë edhe propozime nga ju në KPF dhe kuvend.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – tha se është për keqardhje forma se si na vjen ky material (i cili sapo na erdhi), që është çështja më e rëndësishme brenda vitit që trajtohet. Për aq pak kohë sa pata mundësi ta analizoja projekt-buxhetin, me të vërtetë është qesharake, sepse ka shumë gabime drejtshkrimore tek titujt e projekteve, por ka gabime edhe në përmbajtje. Psh. tek <Infrastruktura publike> nuk kemi fare kod buxhetor. Ceket <kanalizime>, ku do të ndërtohet rrjeti i kanalizimit? Në cilat vende? Sa metra? Pastaj <urat>. Ku do të ndërtohen ato ura? <Sistemi i ujitjes> Kjo është dashur të jetë te Drejtoria për Bujqësi, e jo te infrastruktura publike. Po ashtu, është dashur të sqarohet se çka do të bëhet me sistemin e ujitjes. Si do të realizohet ky projekt? <Pikat pritëse> Ku janë këto pika pritëse? Çfarë rëndësie kanë? <Ujësjetësi>(i shkruar edhe gabimisht). Nëse po mendohet për zgjerimin e rrjetit të ujësjetësit është dashur të shkruhet dhe t'i vendoset kodi buxhetor. Po ashtu, të specifikohet se ku do të bëhet ky zgjerim i rrjetit të ujësjetësit, sa është gjatësia.

Te urbanizmi <Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatra> Në cilat fshatra? Cilat rrugë? Sa është gjatësia?

Te mjekësia <inventar> Nuk është specifikuar se çfarë inventari, sepse ky është term i gjerë. <Inventar mjekësor> E di që ekziston pajisje mjekësore, por inventar mjekësor nuk ka.

Te kultura <ish fabrika e vajit> Çka do të bëhet me to, a do rrënohet apo rinovohet?

<Fusha sportive> Mirë është të ndërtohen fusha sportive. Në cilat lokalitete? Sa fusha sportive do të ndërtohen?

<Memorialet> Ka qenë edhe ide e imja në kuvend që të ndërtohen këto memoriale. Nuk ceket se ku do të ndërtohen. Sa memoriale do të ndërtohen me 100,000.00€ që janë të planifikuara?

<Projektet e arsimit> Për çfarë projekte bëhet fjalë? Mendoj se më e nevojshme është të blehen klima se sa televizorë. Sepse, në muajin qershor dhe shtator për shkak të temperaturave të larta ka qenë e vështirë të mbahet mësim. Mendoj se në vend të televizorëve është më mirë të blihen projektorë apo tabela digjitale.

**Fakete Dushi, anëtare e KPF-së** – tha se para vetes ka disa kërkesa të qytetarëve, e cila propozoi që të futen në draft-buxhet:

- Rruga “Shaip Imeri”, ka filluar por ka mbetur në gjysmë. Aty është hapur një gropë dhe ka mbetur ashtu, për shkak të një qytetari, i cili nuk banon fare aty;
- Ndriçimi i rrugës “Raif Dushi”, si dhe vazhdimi i asfaltimit të kësaj rruge, ku kanë mbetur rreth 150 metra të paasfaltuara;
- Tek varrezat e qytetit në Vushtrri, të ndërtohet një shtëpi e komunitetit;
- Asfaltimi i rrugës “Guria” në Novolan.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – tha se tek shërbimet rezidenciale është planifikuar blerja e veturës vetëm 15.000 euro. Ajo tha se edhe objekti në qendrën rezidenciale ka nevojë edhe për shumë intervenime tjera. Ajo propozoi që të rritet shuma financiare tek shërbimet rezidenciale, që të planifikohen mjete për inventarizim, pajisje tjera.

**Agron Percuku, anëtar i KPF-së** – tha se është për keqardhje kur i sheh këto emërtime të projekteve në draft-buxhet. Po e ceku vetëm një: <Ura e Silnicës deri te Llamkosi>, nuk ka sqarime më tutje. Ai kërkoi që për kuvend, draft-buxheti të vjen me emërtime të projekteve.

**Mentor Hasani, anëtar i KPF-së** – deklaroi se te shëndetësia është e vërtetë që janë tri terme të ndryshme. Inventar mund të jenë tavolina, karriga. Kurse, inventar mjekësor munden me qenë otomanat, paravanat, për këtë arsye edhe i kanë ndarë. Lidhur me atë që e ceku Agroni <Ura e Silnicës deri te Llamkosi>, është një projekt në mes të komunës dhe ministrisë dhe projekti quhet ashtu.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – theksoi se është dashur të sqarohet si projekt psh. <Asfaltimi i rrugës nga Ura e Silnicës deri te Llamkosi>.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – te shëndetësia, po ashtu duhet të specifikohet edhe <ndërtimi i radiologjisë>, se çka është paraparë me këtë.

**Mentor Hasani, anëtar i KPF-së** – tha se radiologjia, është paraparë kabineti i radiologjisë, ku parashihet të ndërtohet një aneks, i cili pritet ta ketë edhe mamografinë. Po ashtu, ka mundësi që të vjen edhe një radiolog.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – tha se për kuvend do të jetë drafti i buxhetit i kompletuar me modifikime dhe specifikime.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – ashtu qysh ka qenë praktikë edhe viteve të kaluara, të bëhet analitika e rrugëve (asfaltim, kubëzim) dhe kanalizimeve.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për”, tri (3) “kundër” (Sylejman Mehulli, Fatmire Cecelia, Agron Perçuku) rekomandoi që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar – qershor 2024.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – lidhur me raportin, i pashë disa përshkrime të kontratave dhe nuk e di a janë bërë ende kontrata valide (a i kanë kaluar filtrat e prokurimit). Disa shifra ishin të larta, te faqja 8, kontratat për furnizime.

- Nr. 41 – Furnizimi me miell dhe artikuj tjerë ushqimorë, pije dhe higjienike – 450,000.00€
- Nr. 48 - Blerja e cisternës zjarrfikëse – 110,000.00€
- Nr. 111 – Hartimi i planit komunal të veprimit për energji, klimë dhe përmirësimi i shërbimeve përmes uljes së shpenzimeve – 90,000.00€
- Nr. 112 – Trajtimi i qenve endacakë – 200,000.00€
- Nr. 113 – Promovimi i Agroturizmit, turizmit urban dhe trashëgimisë kulturore – 260,000.00€
- Nr. 115 – Hartimi i projekteve dyvjeqare – 750,000.00€.

Nëse këto kontrata janë të nënshkruara dhe janë në fuqi, kërkoj që të më përcjellen përmes postës elektronike deri në kuvend.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – pyeti se cilat kontratat janë në fuqi deri në muajin qershor, pasi ky raport është për periudhën janar-qershor.

- Nr. 15 – Furnizim me pemë dhe perime – 16,500.00€;
- Nr. 58 – Furnizim dhe instalimi i pajisjeve zërimi-server për sallën e kuvendit - Vushtrri – 30,000.00€ (Këtu po thuhet që është kryer në qershor, kurse pajisjet në sallë janë të njëjta);
- Lumi “Podrança” – çka ka ndodhë me urën tek ky lum?
- Nr. 59 – Furnizimi dhe mbjellja e drunjve dekorativ – 163,517.00€;
- Nr. 147 – Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatrat Bukosh, Dolak dhe Novolan – 80,000.00€ (Nuk e di që është rregulluar ndonjë rrugë, përveç asaj që është dëmtuar).
- Nr. 159 – Ndërtimi /rikonstruimi i fushave sportive në fshatrat: Maxhunaj, Lumadh, Stanoc, Reznik, Pestovë, Dobërllukë, Pantinë, Shtitaricë, Novolan, Druar, Samadrexhë, Beçiq dhe Bruznik – 100,000.00€. A ka përfunduar si projekt?
- Nr. 139 – Ndërtimi i “Sheshit të Lirisë” në Vushtrri – 200,000.00€. Ku gjendet ky shesh? Kush e ka emërtuar?

Ajo tha se në oborrin e shkollës SHMU-2 nuk kishte ndriçim, por as në klasa nuk kishte. Kështu që, kur të ndërrohet ora është problem të mbahet mësimi, për shkak të errësirës.

**Hava Rruka Mlinaku, Nënkryetare e komunës** – deklaroi se nuk kam informacione për të gjitha aktivitetet e prokurimit, por për disa po ju jap sqarime. Kontrata e mirëmbajtjes është në OSHP, pasi që ka pasur një ankesë. E pashë që në këtë raport ishin të përfshira të gjitha aktivitetet e prokurimit që janë planifikuar dhe që është dashur të inicohen. Pra, ka prej tyre që ende nuk janë inicuar. Aktiviteti i prokurimit për qentë endacakë nuk është inicuar ose ka dështuar, nuk kam informacion të saktë. Aktiviteti i prokurimit për konsulentë është anuluar.

**Albanez Tahiraj, drejtor i Drejtorisë për Arsim** – deklaroi se kontratën e mirëmbajtjes drejtoria e ka dorëzuar, por ende nuk është finalizuar. Po ashtu, edhe kontrata për pemët nuk është finalizuar ende, për këtë jemi duke shikuar një metodë tjetër. Sa i përket

ndriçimit në shkollën SHMU-2, ai tha se nuk ka asnjë problem, sepse asnjë klasë nuk është pa ndriçim. Ka ndoshta mundësi ndonjë klasë të ketë ndriçim më të dobët, por pa ndriçim nuk kemi asnjë klasë, sepse nuk kemi ankesa.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se në SHMU-2 ekziston një kabinet i veçantë që ka projektor, kurse një hapësirë tjetër është me televizor që shfrytëzohet në formë të projektorëve. Ajo rekomandoi që në institucione shkollore ndriçimi të jetë i njëjtë.

***Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të vjen në një format tjetër dhe të dihet se cilat projekte janë realizuar, cilat janë inicuar dhe cilat nuk kanë filluar fare dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

4. Shqyrtimi i Raportit i sistemit të menaxhimit të performancës dhe grantit të performancës për vitin 2023.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – theksoi se raportet e performancës që i punojnë, edhe në kohën kur kemi qenë ne, edhe tash, por edhe në të ardhmen nuk janë matjet reale, sepse treguesit nuk janë shumë bindës. Psh. Drenasi po del kampion, kurse shumë gjëra Vushtrria i ka më mirë. Në faqen 12 <% e arritur në fushat e shërbimeve publike>, transporti publik 46.93%, hapësirat publike 51.59%. Ne nuk kemi stacion të autobusave, nuk kemi linja zyrtare të komunës sonë direkte.

Ajo që më ra në sy është se ato që janë më të rëndësishmet me i publiku, ne e kemi përqindjen më të vogël, psh. publikimi i dokumenteve të prokurimit publik, përqindja është vetëm 67.60%. Mendoj se ky është një nga indikatorët kryesor që komuna duhet t'i rri gati.

**Islam Latifi, koordinator i certifikuar për sistemin e menaxhimit të performancës** – sa i përket sistemit për menaxhim të performancës, ne jemi familjarizuar me këtë sistem. Është me rëndësi të ceket se, tashmë është hartuar edhe ligji i performancës dhe është bërë obligim ligjor. Sa i përket treguesve, është punuar shumë nga zyrtarët e të gjitha komunave, nga ekspertët të ndryshëm të donatorëve, siç janë Demos-i dhe donatorët tjerë, ku jemi munduar të bëjmë tregues të matshëm, në mënyrë që mos të kemi këso dilema. Në fillim kemi pasur shumë tregues, kurse më vonë është bërë rishikimi i tyre dhe reduktimi i tyre. Tash këtë vit, prej 19 fushave i kemi 16.

Komuna ka linja zyrtare të transportit që ipen përmes një ankandë të caktuar. Përveç këtyre, kjo matet edhe me atë se a ka komuna plan të mobilitetit. Kështu që mungesa e planit të mobilitetit, e ka ulur përqindjen e këtij treguesi apo indikatorit. Kemi bërë përpjekje që edhe këtë tregues ta rregullojmë. Ai tha se është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me UN HABITAT-in për hartimin e planit të mobilitetit, i cili do të jetë një projekt njëvjeçar, ku 80% e vlerës do të financohet prej tyre. Përveç fushave, ai tha se një nga treguesit është se a është diskutuar raporti i performancës në kuvendet komunale dhe sa ka qenë përmbajtësor ai debat. Kështu që, ju inkurajoj që të diskutoni në kuvend, në mënyrë që kur të shikohen procesverbalet të shihet se ka pasur debat.

***Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023/2024.

**Sylejman Meholfi, anëtar i KPF-së** – tha se shumë mirë që drejtorja i ka sjell vendet fituese të garave, që është një transparencë dhe një respekt për nxënësit fitues, familjarët, por edhe për shkollat që kanë punuar me nxënësit. Po ashtu, është për të duartrokitur suksesi i pesë nxënësve me pikë nga testi i maturës, si dhe për tre nxënësit të fillores që kanë arritur sukses në testin e arritshmërisë.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – tha se e falënderon komunën që i ka përkrahur nxënësit dhe i kisha inkurajuar që të vazhdojë edhe më tutje t'i përkrah.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri me plotësime rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i nismës së Kryetarit të Komunës për bashkëpunim ndërkomunal për bashkëfinancim me Komunën e Mitrovicës për rregullimin e memorialit të dëshmorit Xhevat Jusufi.

**Hava Rruka Mlinaku, Nënkyetare e komunës** – tha se familjarët e heroit, Xhevat Jusufi na janë drejtuar me kërkesë të dy komunave, ku afër përmendorës po duan ta bëjnë një zgjerim dhe të bëhet rregullimi i memorialit. Është një projekt me një vlerë financiare rreth 80 mijë euro.

**Sylejman Meholfi, anëtar i KPF-së** – deklaroi se rregullimi i memorialit të dëshmorit, Xhevat Jusufi, ish-komandantit të logjistikës të Brigadës 141 "Mehë Uka" është meritë dhe e përkrahim këtë ide. Për kontributin e madh që e ka dhënë Xhevati, vendin e shtatores e ka pasur në qytetin e Mitrovicës.

Por, është mirë që të sqarohet mbiemri a është Jusufi apo Isufi.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

7. Rishikimi i Planit të veprimit për të gjeturat e auditorit.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – kemi qenë të obliguar që si informatë ta sjellim në KPF dhe kuvend. Çdo rekomandim që plotësohet duhet të dëshmohet me fakte konkrete.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje – shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

10. Pyetje dhe përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën **12:00**.

**Bujar Klinaku**



**Procesmbajtës**

**Melihate Basholli - Latifi**



**Kryesuese e KK-së dhe KPF- së**